



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Gjykatësi i vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte*

Vendim për autorizimin e sekuestrimit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I VETËM¹ ka marrë në shqyrtim kërkesën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të Prokurorit të Specializuar me titull “Kërkesë e Prokurorisë për një urdhër për autorizimin e sekuestrimit të dokumenteve” (“kërkesa”), parashtruar ditën e mërkurë, më 16 shtator 2020, dhe në vijim jep vendimin e vet.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi një kërkesë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* për sekuestrimin e dokumenteve që aktualisht besohet se janë në posedim të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”).²

II. PARASHTRIMET

2. ZPS-ja parashtron se më 16 shtator 2020, OVL-UÇK-ja pretendoi se kishte marrë një paketë që përmban dokumente të cilat pretendohet se kanë lidhje me Task Forcën Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe/ose ZPS-në, ndër të cilat dokumente në lidhje me bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe dhe deklarata dëshmitarësh (“dokumente”).³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se qasja e paautorizuar në këto dokumente dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre përbëjnë rrezik të mundshëm të menjëhershëm për hetimet dhe dëshmitarët.⁴

3. Për këto arsye, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të vetëm:

¹ KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

² KSC-BC-2018-01, F00122, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente e Prokurorisë për një urdhër për autorizimin e sekuestrimit të dokumenteve*, 16 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ Kërkesa, para. 1.

⁴ Kërkesa, para. 1.

- (a) të miratojë kërkesën, të urdhërojë Hysni Gucatin (“z. Gucati”) dhe/ose OVL-UÇK-në që t’ia sjellë dhe dorëzojë menjëherë dokumentet ZPS-së, dhe të autorizojë sekuestrimin e dokumenteve;⁵
- (b) të autorizojë ZPS-në, si autoritet kompetent, për dorëzimin dhe zbatimin e urdhrit;⁶
- (c) të urdhërojë z. Gucati, OVL-UÇK-në dhe cilindo individ tjetër që posedon dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre, të mos regjistrojnë ose kopjojnë në asnjë lloj mënyre, dhe të mos shpërndajnë më tej me asnjë mjet komunikimi, dokumentet dhe përmbajtjen e tyre;⁷ dhe
- (d) të paralajmërojë z. Gucati ose cilindo individ tjetër që posedon dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre se, në qoftë se pengojnë zbatimin e vendimit për autorizimin e sekuestrimit të kërkuar ose shkelin kushtet e tij, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit kjo mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës 2019, nr. 06/L-074.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

- 4. Në bazë të nenit 39(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me kërkesë të Prokurorit të Specializuar, gjykatësi i vetëm mund të lëshojë urdhra që mund të nevojiten për hetime dhe për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.
- 5. Në bazë të rregullave 31 dhe 37 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), kontrollimi i një personi, i pronës së tij, ose i vendndodhjeve apo objekteve të tjera në lidhje me të, si dhe

⁵ Kërkesa, para. 5(a)-(c).

⁶ Kërkesa, para. 5(d).

⁷ Kërkesa, para. 4, 5(e).

⁸ Kërkesa, para. 5(f).

sekuestrimi i çfarëdo prove të gjetur gjatë kontrollimit, mund të autorizohet në qoftë se:

- (a) ka pritshmëri të arsyeshme për respektimin e privatësisë në lidhje me vendndodhjet që do të kontrollohen dhe sendet që do të sekuestrohen;⁹
- (b) në lidhje me sekuestrimin e sendeve, është e domosdoshme të ruhen provat për një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe ekziston dyshim i bazuar se prova të tilla gjenden në atë vendndodhje, mjedis apo objekt;¹⁰
- (c) sekuestrimi është i domosdoshëm,¹¹
- (d) sekuestrimi është i pashmangshëm, d.m.th, në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe sekuestrimi që kërkohet duket se është e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit;¹² dhe
- (e) cenimi i shkaktuar mbi të drejtën e personit për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit.¹³

6. Sipas rregullës 37(4) të Rregullores, vendimi që autorizon sekuestrimin përmban:

- (a) orarin, kohëzgjatjen dhe shkallën e sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendndodhjen, mjediset ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa përkatëse, dhe
- (b) procedurën e raportimit në lidhje me zbatimin e

⁹ Rregulla 37(2) e Rregullores. *Shih gjithashtu*, KSC-CC-PR-2017-03, F00006, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05-L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017"), 28 qershor 2017, para. 69.

¹⁰ Rregulla 37(2)(c) e Rregullores.

¹¹ Rregulla 31(1)(b) e Rregullores.

¹² Rregulla 37(1) e Rregullores. *Shih gjithashtu*, Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017, para. 62, 67.

¹³ Rregulla 31(1)(c) e Rregullores.

masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2) të Rregullores.

7. Bazuar në rregullën 39(1) dhe (2) të Rregullores, sekuestrimi duhet të kryhet në prani të personit përkatës, përveçse kur ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë sekuestrimit dhe kur vonesa në zbatimin e tij do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. Prokurori i Specializuar gjithashtu duhet: (a) t'i japë personit përkatës vendimin që autorizon sekuestrimin; (b) ta informojë personin në fjalë për të drejtat e tij; (c) të sigurojë praninë e mbrojtësit të personit, përveçse kur personi heq dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte apo logjikisht nuk mund të pritët prania e mbrojtësit; dhe (d) të sigurojë praninë e një vëzhguesi të pavarur gjatë kryerjes së sekuestrimit.

8. Bazuar në rregullën 32(1) të Rregullores, materiali i sekuestruar mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. Paneli që autorizon sekuestrimin duhet të saktësojë: (a) procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen dhe transferimin e materialit të sekuestruar; (b) kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të sekuestruar; dhe (c) udhëzimet dhe afatet për kthimin ose asgjësimin e materialit të sekuestruar.

9. Neni 35(3) i Ligjit përcakton se policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë përmbushin pa vonesë të papërligjur çdo kërkesë për ndihmë, urdhër apo vendim të Dhomave të Specializuara. Bazuar në rregullën 202(2) të Rregullores, gjykatësi i vetëm mund të urdhërojë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme, ndër të cilat edhe kushtet në lidhje me konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse. Çdo urdhër i tillë përmbushet pa vonesë të papërligjur në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit dhe rregullën 202(3) të Rregullores.

IV. DISKUTIM

A. KUSHTET E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

10. Kërkesa është në lidhje me sekuestrimin e dokumenteve që besohet se janë në posedim të z. Gucati dhe/ose OVL-UÇK-së, sipas informacionit të lëshuar publikisht nga vetë OVL-UÇK-ja.¹⁴ Duke qenë se dokumentet u morën në një paketë të lënë në mjediset e OVL-UÇK-së, gjykatësi i vetëm vlerëson se në lidhje me këto mjedise që ndodhen në adresën Rruga UÇK 77, Prishtinë, Kosovë,¹⁵ mund të ketë pritshmëri të arsyeshme për privatësi. Rrjedhimisht janë të zbatueshme garancitë mbrojtëse të parapara në Ligj dhe në Rregullore.

11. Sipas kërkesës, vetë OVL-UÇK-ja, gjatë një konference për shtyp më 16 shtator 2020, pranoi se dokumentet duket se përmbajnë informacion që ka lidhje me hetimet aktuale të ZPS-së, duke përfshirë dokumente në lidhje me bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe dhe deklarata dëshmitarësh.¹⁶ Për këtë arsye, ekziston dyshim i bazuar se zbatimi i masës së kërkuar do të çojë në sekuestrimin e provave dhe materialit që është pjesë e hetimeve të ZPS-së, ndër të tjera për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh natyrën e këtyre dokumenteve, sekuestrimi i tyre është i domosdoshëm për hetime të tilla, në veçanti për ruajtjen e provave të veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe për mbrojtjen e integritetit të hetimit dhe garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve.

12. Sa i përket kushtit të pashmangshmërisë, gjykatësi i vetëm thekson se sipas informacionit të lëshuar publikisht nga OVL-UÇK-ja, dokumentet përmbajnë informacion të ndjeshëm që si rregull nuk është publik. Pavarësisht nga kjo, OVL-UÇK-ja e bëri publike marrjen e tyre në një konferencë shtypi.¹⁷ Këto rrethana të marra

¹⁴ Kërkesa, para. 1.

¹⁵ Kërkesa, para. 2.

¹⁶ Kërkesa, para. 1.

¹⁷ Kërkesa, para. 1.

së bashku e bëjnë posaçërisht urgjent sekuestrimin, duke qenë se dokumentet nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe për rrjedhojë sekuestrimi i tyre është masa e vetme e efektshme për sigurimin e tyre.

13. Së fundi, në lidhje me proporcionalitetin e cenimit që do t'u shkaktohet të drejtave të z. Gucati ose personave të tjerë të pranishëm në OVL-UÇK kundrejt qëllimit legjitim të hetimit, gjykatësi i vetëm ndër të tjera ka marrë parasysh dhënien në mënyrë anonime dhe spontane të dokumenteve, natyrën e ndjeshme të informacionit në posedim të z. Gucati dhe/ose OVL-UÇK-së, kohëzgjatjen dhe shkallën e masave të kërkuara dhe garancitë mbrojtëse që duhen zbatuar.¹⁸ Duke marrë parasysh përmbajtjen e dokumenteve, qëllimi legjitim i hetimit është ndjekja penale në tërësi e personave përgjegjës për vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, përfshirë ato në bazë të nenit 15(2) të Ligjit. Lidhur me garancitë mbrojtëse që duhen zbatuar, gjykatësi i vetëm rikujton se, ashtu sikurse mishërohet në rregullat 31-33 dhe 39 të Rregullores, ZPS-ja ka për detyrë të marrë masat përkatëse në lidhje me të drejtën për integritet personal, privatësi apo pronë. Në përputhje me sa më lart, në qoftë se kryerja e sekuestrimit u përmbahet kushteve të përcaktuara në Rregullore dhe në këtë vendim, gjykatësi i vetëm konstaton se sekuestrimi i kërkuar është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit.

14. Pasi ka konstatuar se janë përmbushur kushtet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm autorizon sekuestrimin e kërkuar duke qenë se është në përputhje me kushtet e rregullave 31 dhe 37 të Rregullores.

B. ORARI, KOHËZGJATJA DHE SHKALLA E SEKUESTRIMIT

15. Për sa i përket afatit për kryerjen e sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i vetëm merr parasysh nga njëra anë urgjencën e masës së kërkuar si rezultat i njoftimit publik të OVL-UÇK-së, natyrën e ndjeshme të informacionit në posedim të OVL-UÇK-së dhe

¹⁸ Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017, para. 64.

kohën që i duhet ZPS-së për organizimin e sekuestrimit të kërkuar dhe, nga ana tjetër, pritshmërinë e arsyeshme të z. Gucati për privatësi si dhe nevojën për mbikëqyrje gjyqësore të zbatimit të këtyre masave. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm gjykon se për kryerjen e sekuestrimit të kërkuar mjaftojnë pesë ditë, llogaritur nga data e lëshimit të këtij vendimi.

16. Sekuestrimi i kërkuar duhet të kufizohet në: (i) materialin që z Gucati dhe/ose OVL-UÇK-ja morën në pasditen e të mërkurës, 16 shtator 2020; dhe (ii) çfarëdo materiali të ngjashëm që ka lidhje e që mund të merret midis lëshimit të këtij vendimi dhe kryerjes së sekuestrimit të kërkuar.

C. RAPORTIMI MBI KONTROLLIMIN DHE SEKUESTRIMIN

17. Në përputhje me rregullat 31(2) dhe 37(4)(b) të Rregullores, ZPS-ja duhet të raportojë mbi zbatimin e masave të kërkuara. Duke marrë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e një raporti pas zbatimit të masës së kërkuar, ZPS-ja duhet të dorëzojë një raport brenda 14 ditësh nga përfundimi i sekuestrimit të kërkuar, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 5-ditësh të përcaktuar për kryerjen e sekuestrimit të kërkuar, në cilëndo datë të mëhershme. Raporti duhet të përmbajë (i) datën, orën, kohëzgjatjen, vendndodhjen, shkallën dhe rrethanat e sekuestrimit; dhe (ii) përmbushjen e kushteve të rregullës 39 të Rregullores.

D. MBAJTJA, RUAJTJA DHE MBROJTJA E MATERIALIT TË SEKUESTRUAR

18. Gjykatësi i vetëm e vlerëson të nevojshme që ZPS-ja të ruajë, mbrojë dhe transferojë materialin e sekuestruar në përputhje me procedurën standarde të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje. Gjatë kësaj, ZPS-ja duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e materialit të sekuestruar nga humbja, qasja e paqëllimshme ose e paautorizuar, ndryshimi, shpërndarja apo asgjësimi. Në raportin e vet, ZPS-ja

informon gjykatësin e vetëm për procedurën dhe masat paraprake përkatëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar.

19. Gjykatësi i vetëm gjykon se për vlerësimin e rëndësisë së materialit të sekuestruar mjafton një afat kohor prej katër muajsh, llogaritur nga data e kryerjes së sekuestrimit të kërkuar. Në qoftë se konstatohet se materiali është i rëndësishëm për hetimin apo për procese të ardhshme gjyqësore, në pajtim me rregullën 33(1)(b) të Rregullores, ZPS-ja mund ta mbajë materialin deri kur ai pushon së qeni i rëndësishëm në lidhje me qëllimin për të cilin është marrë. Në atë rast, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet në përputhje me rregullën 33(2)-(3) të Rregullores. Në qoftë se materiali i sekuestruar nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është marrë dhe nuk është i rëndësishëm për hetimin e ndonjë vepre penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet menjëherë, në përputhje me rregullën 33(1)(a)(i) dhe (2)-(3) të Rregullores.

E. DORËZIMI DHE ZBATIMI I URDHRIT TË KËRKUAR

20. Meqenëse sekuestrimi i kërkuar do të kryhet në Kosovë, gjykatësi i vetëm rikujton se në përputhje me nenin 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, edhe ZPS-ja mund të konsiderohet "autoritet kompetent" sipas rregullës 49(1) të Rregullores, i aftë për dorëzimin dhe zbatimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të tjera edhe të sekuestrimit të kërkuar. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm autorizon ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë vendim.¹⁹ Nëse është e nevojshme, ZPS-ja mund ta bëjë këtë në bashkëpunim me autoritetet kompetente në Kosovë.

¹⁹ Duke e informuar Prokurorin e Specializuar për këtë urdher, transmetimi i urdhrin konsiderohet i kryer në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores.

F. MOSSHËRNDARJA E DOKUMENTEVE

21. Duke marrë parasysh natyrën e ndjeshme të dokumenteve dhe rrezikun konkret që shpërndarja e mëtejshme e tyre nga z. Gucati dhe/ose OVL-UÇK-ja mund të përbëjë për sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve si edhe për integritetin e hetimeve të ZPS-së, duke u bazuar në nenin 39(3) të Ligjit, gjykatësi i vetëm e gjykon të nevojshme të urdhërojë z. Gucati, OVL-UÇK-në dhe cilindo individ tjetër që ka në posedim dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre, që të mos regjistrojnë ose kopjojnë në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndajnë më tej me asnjë mjet komunikimi, dokumentet ose përmbajtjen e tyre.

V. VENDIM

22. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm:

- a. **AUTORIZON** sekuestrimin e kërkuar të dokumenteve në posedim të Hysni Gucatit dhe/ose OVL-UÇK-së, në adresën Rruga UÇK 77, Prishtinë, Kosovë, sikurse përcaktohet me hollësi në paragrafin 16 më lart;
- b. **AUTORIZON** ZPS-në që ta bëjë të njohur këtë vendim për aq sa është e përshtatshme dhe e domosdoshme për zbatimin e tij; dhe
- c. **URDHËRON** Hysni Gucatin, OVL-UÇK-në dhe cilindo individ tjetër që posedon dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre, të mos regjistrojnë ose kopjojnë në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndajnë më tej me asnjë mjet komunikimi dokumentet dhe përmbajtjen e tyre.

23. Meqenëse sekuestrimi i kërkuar do të kryhet në Kosovë, gjykatësi i vetëm **AUTORIZON** ZPS-në të dorëzojë dhe zbatojë këtë vendim në përputhje me paragrafët 15-16 dhe 20 më lart dhe rregullën 39 të Rregullores.

24. Pavarësisht se ku do të kryhet sekuestrimi i kërkuar, gjykatësi i vetëm:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të raportojë mbi kryerjen e sekuestrimit brenda 14 ditësh nga përfundimi i sekuestrimit, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit i 5-ditësh të paraparë për kryerjen e sekuestrimit, në cilëndo datë të mëhershme, në përputhje me paragrafin 17 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të mbajë, ruajë dhe mbrojë materialin e sekuestruar dhe të raportojë mbi procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit, në përputhje me paragrafin 18 të këtij vendimi; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në të vlerësojë rëndësinë e materialit të sekuestruar brenda katër muajsh nga data e kryerjes së sekuestrimit të kërkuar, si dhe të mbajë në ruajtje, kthejë ose asgjësojë materialin e sekuestruar sikurse përcaktohet në rregullën 33 të Rregullores, në përputhje me paragrafin 19 të këtij vendimi.

25. Gjykatësi i vetëm paralajmëron Hysni Gucatin dhe cilindo individ tjetër që posedon dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre se, në qoftë se pengojnë zbatimin e këtij vendimi ose shkelin kushtet e tij, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit kjo mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës 2019, nr. 06/L-074.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i vetëm

E enjte, 17 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.